



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA PËRMET**  
**KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Datë 14/10/2023

**PROCES VERBAL**

**Konsultimi për Buxhetin dhe Paketën Fiskale 2024**

**Vendi** : Njësia Administrative Petran

**Ora** : 18:00

**Tema e konsultimit** : Buxheti dhe Paketa Fiskale 2024.

I mbajtur sot më datë 14 Tetor me pjesëmarrjen e Kryetares së Bashkisë, znj. Alma Hoxha, Kryetares së Këshillit Bashkiak, znj. Anila Dhimitri, nën/Kryetarit z. Florand Hasani dhe Administratorit të njësisë Petran zYlli Dervishi. Gjithashtu pjesëmarrës janë palë të interesuara, subjekte dhe banorë të zonave përreth. Takimi u hap nga znj. Alma Hoxha e cila fillimisht falenderoi të gjithë të pranishmit. Më pas Kryetarja u shpreh se është në dijeni të disa prej problematikave të zonës dhe u sigurojë atyre se shumë shpejt do të fillojnë investime të rëndësishme në zonë për rehabilitimin e kanaleve vaditëse dhe ujësjellësat e fshatrave. Në vijim të muajit do të kryhet dhe procesi i zgjedhjes së Kryetarëve të Fshatrave.

Në vijim banorët paraqitën disa nga problemtikat më kryesore të zonave të tyre si

**Kaludh**

- Vendorsja e kazanëve për mbeturina
- Rehabilitim i Rrugës së Mesit
- Rehabilitim i Rrugës së Kaludhit të Vjetër
- Rishikim i tarifës së vaditjes nga rezervuari

**Qilarisht**

- Mirëmbajta e rrugës së fshatit
- Pastrim i kanalit kullues

**Gjinkar**

- Problematika me ujin e pijshëm dhe nevoja për të pastruar depon e ujit
- Pastrim i ambienteve të varrezave të fshatit
- Rehabilitim i kanaleve kulluese



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA PËRMET**  
**KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK**

**Bënjë**

- Rehabilitim i rrugës së fshatit

**Bodar**

- Rikonstruksion i urave të Tremishtit
- Problematika me ujërat e zeza
- Problematika me ujërat e shirave

**Skutaraq**

- Probleme me ujën e pijshëm pas shtimit të bizneseve në zonë
- Kërkesë ARRSH për të vëndosur pengesa në rrugë

Kryetari i Komisionit të Ekonomisë z. Agathokli Proko u shpreh se duhet të mblidhen të ardhura në mënyrë që ato të kthehen si investime tek banorët. Ai shtoi gjithashtu se të gjitha këto problematika të shfaqura duhet të trajtohen me kujdes edhe nga Administratori i Njësisë.

Më pas fjalën e mori Kryetarja e Këshillit Bashkiak, znj. Anila Dhimitri e cila informoi banorët se sapo janë miratuar në Këshill prioritetet në investime. Ajo shtoi se këto takime e ndihmojnë mjaft Bashkinë të njohë edhe më shumë nevojat e komunitetit.

Në fund të takimit znj. Alma Hoxha u tregoi banorëve se viti 2024 do të kete investime në menaxhimin e mbetjeve. Gjithashtu znj. Kryetare i falenderojë edhe një herë banorët e pranishëm dhe u shprehu atyre gatishmërinë e saj për të zhvilluar takime të tjera duke i konsideruar si mjaft të rëndësishme në vendimmarjet e ardhshme.

**Konceptoi:**

**Koordinatori i Konsultimit Publik**

**Albion Naska**

**SEKRETARI PËRGJITHSHËM**

**Denisa DURO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA PËRMET**  
**KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK**

**Foto nga takimi:**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA PËRMET**  
**KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK**





---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA PËRMET**  
**KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK**